



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Datë: 31.05.2018

Në mbështetje të nenit 53, paragrafit 3, dhe nenit 80B të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-222, Ligjin Nr. 04/L-116, Paragrafi 1.4 të Rregullores Nr. 02./2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dhe Vendimit Nr. 05/89 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e datës 25.05.2016, nenit 8 të Rregullores mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve dhe Ftesës Publike për mbështetje financiare të projekteve/ programeve të OJQ-ve për shkathtësi të buta për të rinj, bazuar në Vendimin Nr. 848/2018 për formimin e Komisionit për vlerësimin e projekteve të paraqitura nga OJQ-të, Komisioni Vlerësues nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Në përputhje me detyrat dhe afatet e Komisionit të përcaktuar me vendimin e lartpërmendur dhe duke u bazuar në Thirrjen Publike të datës 20.04.2018, Komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar të gjithë dokumentacionin përkatës, të dërguar nga OJQ-të, ku sipas kriterëve komisioni vlerësues ka shpallur fitues për subvencionim këto OJQ:
 1. OJQ "MDA Foundation"
 2. OJQ "Prishtina - REA"
 3. OJQ "Kosovar Institute for Science and Education -KISED"
 4. OJQ "Business Support Centre Kosovo -BSCK"
 5. OJQ "SH.B.GJ.D.K- Demokracia"
 6. OJQ "Instituti për Menaxhim dhe Zhvillim -IMD"
 7. OJQ "Ekovizioni"
 8. OJQ "Vece Kongresa Bosnjacki Intelektualaca Kosova -VKBIK"

ARSYETIMI

Komisioni për Vlerësim brenda afateve të përcaktuar ka bërë hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni të dorëzuar nga OJQ-t. Në fazën e parë në bazë të kriterëve formale administrative nga 25 (njëzetë e pesë), kriteret i kanë plotësuar 14 (katërmëdhjetë) OJQ.

Fazës së dytë të vlerësimit i janë nënshtruar 14 (katërmëdhjetë) OJQ sipas kriterëve të thirrjes publike në komponentën e punësimit, ku komisioni ka vlerësuar secilin aplikacion në mënyrë individuale e të pavarur dhe ka vlerësuar se 8 (tetë) OJQ të listuar më lartë plotësojnë kriteret e përcaktuara në thirrjen publike dhe kualifikohen për të përfituar mbështetje financiare nga MKRS-ja.

Komisioni për vlerësim ka vlerësuar se 6 (gjashtë) aplikacione nuk kanë plotësuar kriteret e thirrjes publike dhe si rrjedhojë nuk kanë marrë pikët e nevojshme për tu kualifikuar për mbështetje financiare.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ fituese duhet të paraqesin prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara.

Nëse aplikuesi nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar shtesë brenda 7 ditësh, aplikimi do të refuzohet dhe nuk do të merret në konsideratë për nënshkrim të kontratës.

Udhëzim Juridik: Kundër këtij vendimi lejohet ankesë në afat prej 5 ditësh nga data e publikimit të këtij vendimi, nëpërmjet arkivës së MKRS-s.

Kryesuesi i komisionit:
Burim Mexhuani - Kryesues

Anëtarët e komisionit:
Flora Salihu - anëtare

Jetmira Fetoshi - anëtare

Fehmi Ramadani - (ekspert i jashtëm, anëtar)

Berhil Shasivari - (anëtar nga shoqëria civile/OJQ)

